



KOMUNA E RAHOVECIT

**RAPORT
NËNTËMUJOR I
PUNËS**

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE
PËRKUJDESJE SOCIALE
JANAR - SHTATOR 2023**

RAPORT NËNTEMUJOR I PUNES

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	2
AKTIVITETET.....	2
PËRFUNDIM.....	4

RAPORT NENTEMUJOR I PUNËS

DATË /A:	03.10.2023
REFERENC-Ë:	Raport nëntemujor i punës
PËR/ZA/TO:	z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës
CC:	z.Ali Morina – Shef i Kabinetit
NGA/OD/FROM:	znj. Saranda Sallteku – Drejtore e DSHPS - së
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport

HYRJE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë periudhës raportuese janar – shtator, ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimitarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjërë.

Fushë veprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2023, ky raport përfshin në mënyrë gjithëpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimitarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitet e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

AKTIVITETET

- DSHPS qysh në fillim të vitit 2023 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësive të përshkruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit- shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nepunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHPS-së;
- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesish për ndihma momentale.
- Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme, përvizimi i objektit të AMF-së, ne lagjen nr.3,

RAPORT NËNTËMUJOR I PUNËS

- Është duke funksionuar shërbimi mjekësor "Kujdesi Shtëpiak", i cili do ta lehtësojë marrjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata më sëmundje të rënda, të cilët e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të. Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime mjekësore nga ora 07:00 deri në 21:00. Janë kryer 191 vizita mjekësore shtëpiake nga ekipi mobil;
- Në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, po ashtu dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat: Krushë e Madhe, Sapniq dhe Dobidol;
- Janë mbajtur ligjérata vetëdijësuese në QKMF në Rahovec me tema si: Pandemia COVID – 19, Vaksinimi AntiCovid, Trajtimi i prostatës me avull, Astma, etj.;
- Është themeluar Këshilli i Pacientëve në Komunën e Rahovëcit, i përbërë nga 5 anëtarë, mandati i anëtarëve të Këshillit të Pacientëve është 3(tre) vjeçar;
- Në kuadër të marrëveshjes me AQH – në, po trajnohen mjekët dhe infermieret pranë QKMF –së në Rahovec, po ashtu AQH asiston në implementimin e mjekësisë familjare;
- Një veturë donacion kemi pranuar nga UNICEF për shërbimin për vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë nga mosha 0 deri në 3 vjeç;
- Janë kryer vizitat sistematike te nxënësve ne shkollat e komunës se Rahovëcit.
- Jemi duke punuar në funksion të avancimit të shërbimeve shëndetësore dhe për këtë qëllim kemi pranuar Personel Shëndetësor për 42 vende të reja të punës për : mjekë, stomatologë dhe infermierë;
- Në Qendrën Kryesore e Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti" në Rahovec, kemi vënë në funksion aparatin e mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit. Aparati i mamografit vlerësohet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin shëndetësor, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovëcit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave si shtyllë kryesore e familjes dhe mirëqenies së saj;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrjet-ftesat për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë.

RAPORT NËNTËMUJOR I PUNËS

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Është bërë përrurimi i Objektit të vjetër të QKMF – së në Rahovec;
- Jemi pajisur me dy Auto Ambulanca për nevojat e QKMF-së.
- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i komunës.
- Nga donacion është pajis me mjete laboratorike laboratori ne QMF ne Krushë te Madhe
- Kemi pranuar një donacion nga mërgimtarët pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, në vlerë prej 200,000.00 euro.
- Është bërë përrurimi i objektit të ri të AMF-së, në lagje të eperme, lagja nr.3
- Ka filluar Dezinfektimi i objekteve shëndetësore, të të gjitha objekteve shkollore, si dhe hapsirave publike.
- Vazhdojnë punimet në renovim të objektit të vjetër të QKMF-së, fasadimi i jashtëm i objektit.
- Ka filluar renovimi i të gjitha objekteve të QMF-ve, dhe AMF-ve.

Mirëgenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushe veprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendor dhe të huaj, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

PËRFUNDIM

Ky raport nëntëmujor paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:

Me respekt!